REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ALKET Z. MANÇKA
ADRESA NR.2, ASIM ZENELI, NR.10, NR.6
TEL: 693645101

# KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

**Nr. repertori: 7301** **Nr. koleksioni: 3091**

**Tirane më 02/09/2025**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË ALKET Z MANÇKA NOTER TIRANË

Ligjet referuese:

1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar

2.Ligji nr. 124/2024, datë 19/12/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale"

3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

A2025051400246090270

*Akti noterial përbëhet nga 3 fletë

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DEGA E NOTERISE TIRANE
ZYRA NOTERISE TIRANE
Nr. 7301 Rep. Nr. 3091 Kol.

A202505140024609027O

# KONTRATE SHITJE KUOTASH

Sot, ne date 02 . 09 .2025, ne Tirane, para meje noter Alket Z. Mançka prane Dhomes se Noterise Tirane, Zyra Noteriale Tirane, Lagjia Nr. 2 ; Rruga " Asim Zeneli " Pll. Nr 10, u paraqiten personalisht palet si me poshte:

**PALA SHITESE:**

**LE XU**, atësia JIANGSHEBG, amësia JIANPING, shtetas Kinez, lindur në JIANGSU dhe banues në JIANGSU, me adresë Tirane, lindur më 13/03/1986, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Pashaporte nr. EC9307062 , ne cilesine e **Administratorit dhe Ortakut me pjesemarrje 100 % te kuotave te Shoqerise " NEO ASIA " SHPK** , regjistruar si person juridik në QKB (Qendra kombëtare e bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NUIS M51417504R , me adresë Lagja 14 Shkozet Rruga Baram Tusha Nd 124 H1, Durres.

(ketu me poshte te quajtur **Shites**).

**PALA BLERESE:**

**ANJAN SHRESTHA,** atësia ASHOK, amësia PARTATI, shtetas Nepal, lindur në Gorkha Nepal dhe banues në Gorkha Nepal, lindur më 17/04/2002, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Pashaporte Nepaleze me nr.12198304.

(ketu me poshte i quajtur **Bleres**).

**MEQENESE:**
Pala Shitese **LE XU** , zoteron 1 (nje) kuote, me pjesemarrje respektive te pershkruar si me poshte te **Shoqeria "NEO ASIA " shpk:**

1. **LE XU** zoteron 1 (nje) kuote me vlere 13.000,00 dhe me pjesemarrje totale prej 100% ne Shoqeria **"NEO ASIA" shpk**, i cili shet 100% te kuotes se vet respektive te pala blerese ANJAN SHRESTHA.

I cili mbas shitjes nuk do te zoteroje asnje kuote ne Shoqerine **"NEO ASIA " shpk** , ndersa pala blerese **ANJAN SHRESTHA,** mbas shitjes do te zoteroje 1 (nje) Kuote dhe pjesemarrje 100% ne Shoqerine **"NEO ASIA " shpk**.

## NENI 1
## OBJEKTI I KONTRATES

Ne perputhje me kushtet dhe dispozitat e kesaj kontrate shitesi: 1- **LE XU** , i shet bleresit **ANJAN SHRESTHA** , 100% te kuotes se vet respektive te cituar dhe pershkruar si me siper te shoqerise **"NEO ASIA " shpk** , e cilat ne total perfaqeson 100% te pjesemarrjes ne shoqeri, te lire prej cfaredo pengu apo barre, per nje shperblim te barabarte me ate te percaktuar ne nenin 2 te kesaj Kontrate.

Transferimi i pronesise mbi kuoten do te kryhet me nenshkrimin e kesaj Kontrate nga Palet.

- Bleresi **ANJAN SHRESTHA** do te behet pronar i 1 (nje) kuote, e cila perfaqeson 100% te pjesemarrjes ne Shoqeri dhe te kapitalit themeltar te Shoqerise **"NEO ASIA " shpk** dhe do te siguroje cdo disident te deklaruar dhe te paguaj te gjitha detyrimet dhe te drejtat qe burojne nga titulli i pronesise mbi kuotat.

## NENI 2
## CMIMI I BLERJES

2.1 Me nenshkrimin e kesaj Kontrate, Shitesi transferon dhe dorezon tek Bleresi kuoten respektive perkundrejt vleres/cmimit si me poshte:

A202505140024609027O

1- **LE XU** shet 100% te kuotes se vet respektive te Shoqerise **"NEO ASIA" shpk**, e cila perfaqeson 100% te kapitalit te shoqerise, kundrejt vleres prej 5.000 Euro .

**2.2** Pagesa do te kryhet sipas marrveshjes midis paleve .

**2.3** Shitesi pranon qe regjistrimi i kesaj kontrate prane Regjistrit Tregetar, prane Qendres Kombetare te Regjistrimit te kryhet menjehere pas nenshkrimit te kesaj kontrate nga te dy palet.

## NENI 3
## DEKLARIME DHE GARANCI TE SHITESIT

**3.1** Ne daten e nenshkrimit te kesaj Kontate, Shitesi deklaron dhe garanton se:

1) Eshte zoterues i ligjshem i numrit te kuotave te percaktuara ne nenet e mesiperme te kesaj Kontrate.
2) Kuotat jane te lira prej cfaredo pengu apo barre te cfaredolloji dhe Shitesit gezojne te drejten, kompetencen dhe autoritetin e plote te shesin, kalojne, transferojne dhe dergojne kuotat ne perputhje me kushtet e kesaj Kontrate.
3) Shitesi ka te gjitha kompetencat per te nenshkruar dhe ekzekutuar kete Kontrate.
4) Shoqeria zhvillon aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe operon e pajisur me licensen e rregullt te leshuar nga autoritetet kompetente.
5) Nuk kerkohet asnje miratim nga autoritetet licensuese per te shitur, kaluar, transferuar ose derguar kuotat tek Bleresi.

## NENI 4
## DEKLARIME DHE GARANCI TE BLERESIT

**4.1** Ne daten e nenshkrimit te kesaj Kontrate, Bleresi deklaron dhe garanton se nuk ka asnje pengese ligjore per lidhjen e kesaj Kontrate.

**4.2** Bleresi deklaron se eshte ne dijeni te plote te situates ligjore dhe financiare te Shoqerise, te aseteve ne pronesi te Shoqerise dhe e pranon shoqerine sic eshte ne daten e transferimit te pronesise, me te gjitha te drejtat dhe detyrimet.

## NENI 5
## SHPENZIMET DHE TAKSAT

**5.1** Pervec se kur parashikohet ndryshe nga kjo Kontrate, secila nga Palet do te paguaje vete shpenzimet ne lidhje me negocimin dhe pergatitjen e kesaj Kontate.
**5.2** Te gjitha kostot per sherbimet e noterizimit dhe kosto te tjera te perballuara ne lidhje me nenshkrimin dhe zbatimin e kesaj Kontrate do te perballohen nga Bleresi.

## NENI 6
## LIGJI I ZBATUESHEM DHE ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE

**6.1** Kjo Kontrate si dhe te drejtat dhe detyrimet qe rrjedhin per Palet nga kjo Kontrate do te rregullohen, interpretohen dhe zbatohen ne perputhje me legjislacionin shqiptar aktualisht ne fuqi.

**6.2** Ne rast se lindin mosmarreveshje midis Paleve ne lidhje me interpretimin, lidhjen, zbatimin, shkeljen, zgjidhjen dhe ekzekutimin e kesaj Kontrate, Palet do te kryejne cdo veprim me mirebesim per zgjidhjen me mirekuptim te mosmarreveshjes.
**6.3** Te gjitha mosmarreveshjet te cilat do te lindin midis Paleve ne lidhje me zbatimin e kesaj Kontrate, dhe qe nuk mund te zgjidhen me mirekuptim, do te zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

PULLE TARIFE PULLE TARIFE PULLE TARIFE

A20250514002460902 70

PULLE TAKSE

## NENI 7
## FORCA MADHORE

**7.1** Asnjera nga Palet nuk do te konsiderohet pergjegjese nese permbushja e dispozitave te kesaj Kontrate do te jete ne vonese ose e pamundur per shkak te forces madhore, dhe vecanterisht si rezultat i revolucioneve, kryengritjeve, protestave popullore, luftes, grevave, zjarrit, permbytjeve apo fenomeneve te mbinatyrshme te cilat kufizojne lirine personale dhe ate te sipermarjes se Paleve.

## NENI 8
## DISPOZITA TE NDRYSHME

**8.1** Kjo Kontrate perben marreveshjen e plote midis Paleve ne lidhje me ceshtjen objekt te kesaj Kontrate, dhe mbizoteron mbi te gjitha marreveshjet e meparshme me shkrim ose me goje, si dhe mbi te gjitha komunikimet ndermjet Paleve ne lidhje me ceshtjen objekt te kesaj Kontrate.

**8.2** Pervec se kur eshte parashikuar ndryshe ne kete Kontrate, cdo ndryshim i saj mund te kryhet vetem me shkrim dhe te nenshkruhet nga te dyja Palet.

**8.3** Palet bien dakort qe kushtet e kesaj Kontrate te mbeten konfidenciale dhe nuk mund te behen publike tek te tretet, pervec se kur berja publike lidhet me permbushjen e detyrimeve ligjore.

**8.4** Kjo Kontrate perpilohet ne 4 kopje me vlere te barabarte.

**PALA SHITESE**
**LE XU**

Le Xu

**PALA BLERESE**
**ANJAN SHRESTHA**

ANJAN SHRESTHA

PERKTHYESE ZYRTARE EDLII SHKOKOTA Tel: +355696028923 E.mail: e.shkokota@live.com TIRANE ALBANIA

**NOTER**
**ALKET Z MANÇKA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

# EKSTRAKT HISTORIK I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT "SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR"

## GJENDJA E REGJISTRIMIT

| | | |
|---|---|---|
| 1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS) | M51417504R | |
| 2. Data e Regjistrimit | 17/02/2025 | |
| 3. Emri i Subjektit | Neo Asia | |
| 4. Forma ligjore | SHPK | |
| 5. Data e themelimit | 05/02/2025 | |
| 6. Kohëzgjatja | Nga: 05/02/2025 | |
| 7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri | Durres Durres Lagja 14 Shkozet Rruga Baram Tusha Nd 124 H1, Durres | |
| 8. Kapitali | 13.000,00 | |
| 8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave | 1,00 | |
| 9. Objekti i aktivitetit | Aktivitet per import dhe tregti te artikujve te ndryshem me mbizoterim ushqimor | |
| 10. Administratori/ët | Le Xu | |
| 10.1 Afati i emërimit | Nga: 05/02/2025 | Deri: 05/02/2030 |
| 11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore | | |
| 11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka) | | |
| 12. Ortakët | Le Xu | |
| 12.1 Vlera e kapitalit | Para: 13.000,00 | Natyre: |
| 12.2 Numri i pjesëve | 1,00 | |
| 12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%) | 100,00 | |
| *Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse një kuotë zotërohet në bashkëpronësi)* | | |

NOTER TIRANE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT

QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

| | |
|---|---|
| 12.4 Komente (nëse ka) | |
| 13. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit | |
| 14. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht | Emri Tregtar: Neo Asia<br>E-Mail: sokolixu@gmall.com<br>Telefon: 355694083033 |
| 15. Statusi: | Aktiv |

Lista e Dokumenteve:
Akti i themelimit
Statuti (nese eshte hartuar si dokument i ndryshem nga akti i themelimit)

Regjistrimi Fillestar: CN-411430-02-25

## HISTORIKU I REGJISTRIMIT

| Data e regjistrimit | Ndryshimi i te dhenave te regjistruara |
|---|---|

Datë: 02/09/2025

Vulosur elektronikisht nga
Qendra Kombëtare e Biznesit
Date:2025/09/02 11:48:27 +02:00
M51417504R2025090211481842
3006

*Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra Kombëtare e Biznesit)*

RBS
Regjistri i Barrëve Siguruese

Rr. e Dibres, Qendra e Biznesit Observator
Selvia, Kati XII
TIRANE, SHQIPERI
TEL/FAX.:355 4 2420005
TEL:355 4 2420006
Email: rbs@roen-al.com

# REZULTATET E KERKIMIT

| | |
|---|---|
| Numri i Rezultatit te kerkimit: | D-20250829120110758 |
| Data e Rezultatit te Kerkimit: | 29.08.2025 |
| Ora e Rezultatit te Kerkimit: | 12:01:10 |
| **Lloji i Kerkimit:** | **Emri i Personit Fizik** |
| Numri i Dokumentit: | D-400-673-3505 |

**LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KERKIMI: 0**

**LE JIANGSHEBG XU**

Fundi i Rezultatit te Kerkimit

Fundi i Dokumentit

Regjistri i Barrëve Siguruese

Rr. e Dibres, Qendra e Biznesit Observator
Selvia, Kati XII
TIRANE, SHQIPERI
TEL/FAX.:355 4 2420005
TEL:355 4 2420006
Email: rbs@roen-al.com

# REZULTATET E KERKIMIT

| | |
|---|---|
| Numri i Rezultatit te kerkimit: | D-20250829120110758 |
| Data e Rezultatit te Kerkimit: | 29.08.2025 |
| Ora e Rezultatit te Kerkimit: | 12:01:10 |
| **Lloji i Kerkimit:** | **Emri i Personit Juridik** |
| Numri i Dokumentit: | D-400-673-3505 |

LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KERKIMI: 0

**NEO ASIA SH.P.K.**

Fundi i Rezultatit te Kerkimit

Fundi i Dokumentit

REGJISTRI I BARREVE SIGURUESE R.B.S. TIRANE ALBANIA

**SUBJEKTI KERKUES:**

Emertimi
ALKET ZIQIRI MANCKA P.F.

Valbona Jaho

**TE DHENAT E PERDORUESIT:**

Emri dhe Mbiemri
VALBONA JAHO